

36949

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
NR 26949 VENDIMI

V E N D I M

PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane sot me date 25/9/ 2006 ,Une Gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane M. Dega mbasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Hamdi Mesi per regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DRAGO " SHPK me seli ne Nikel -Kruje .

K O N S T A T O V A

Se kerkesa e kerkueses Hamdi Mesi , per regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " DRAGO " SHPK ,me ortak te vetem dhe Administrator kerkuesin Hamdi Mesi ,me Drejtues teknik Ibrahim Brama me kapital themeltare 4.000.000 leke ne emer te ortakut vetem Hamdi Mesi ,me kohegjatje te veprimtarise mbi 10 vjete ,me objekt : Kryerja e sherbimeve te kategorise (a + b), ruajtja e objekteve shteterore dhe private vendase dhe te huaja , ruajtja e rendit ne keto objekte dhe sigurimi i jetes se personelit e te vlerave pasurore te tyre gjate levzijes .

Eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet

P E R K E T O A R E S Y E

Ne baze te ligjit 7512 date 10.08.1991 ,Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare " dhe ligjit 7667 date 28.01.1993 dhe ligjit 8770 date 18.04.2001 "Per sherbimin e Ruajtjes dhe sigurise Fizike " ?

V E N D O S A

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " DRAGO " SHPK ,me ortak te vetem dhe Administrator kerkuesin Hamdi Mesi ,me drejtues teknik Ibrahim Brama me kapital themeltare 4.000.000 leke , ne emer te ortakut vetem Hamdi Mesi ,me kohegjatje te veprimtarise mbi 10 vjete ,me objekt :Kryerja e sherbimeve te kategorise (a + b) , ruajtja e objekteve shteterore dhe private vendase dhe te huaja , ruajtja e rendit ne keto objekte dhe sigurimi i jetes se personelit e te vlerave pasurore te tyre gjate levzijes .

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne shkallen e dyte .

GJYQTARE
Majlinda Dega
[Signature]

AKT THEMELIMI

i

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "DRAGO" SHPK



Ne Tirane sot me date 11 shtator 2006 (dymije e gjashte) une i nenshkruaj Hamdi Mesi banues ne Nikel - Kruje, me cilesine e ortakut te vetem, me vullnet te lire e te plote, vendosa te krijoj Shoqerine private "DRAGO" shpk (SH.R.S.F).

Ne kuptimin e ketij akti themelues, ortakut i vetem Hamdi Mesi eshte themeluesi i shoqerise private "DRAGO" shpk me qender ne Nikel - Kruje dhe shtrirja ne te gjithe teritorin e vendit. Shoqeria private "DRAGO" shpk (SH.R.S.F) Nikel - Kruje rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me aktin e themelimit, statusin e saj, dhe ne baze te kritereve te percaktuara ne ligjin nr. 7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire, veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit "Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, Kodit Tregetare te Republikes se Shqiperise, Ligjit nr. 8770 date 19.04.2001 "Per sherbimin e ruajtjes dhe te sigurise" akte te tjera ligjore.

Neni 1

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise dhe aktiviteti i kesaj shoqerie private do te jete :

Ruajtja e objekteve shteterore dhe private vendase dhe te huaja ne te gjithe teritorin e vendit, ruajtja e rendit ne keto objekte dhe sigurimin e jetes se personit dhe te vlerave pasurore te tyre gjate levizjes.

Neni 2

AFATI I VEPRIMTARISE

Veprimtaria e shoqerise do te jete efektive nga dita e regjistrimit ne regjistrin tregetare prane gjykates se rrethit gjyqesor Tirane, si dhe paisjen me lejen e ushtrimit te profesionit nga organet kompetente.

Aktiviteti privat i Shoqerise do te zhvillohet me nje kohezgjatje prej me shume se 10 vjet.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 3

Kapitali themeltar i shoqerise tregtare private "DRAGO " Shpk (SH.R.S.F), perbehet nga kontributi fillestare i themeluesit te shoqerise dhe arrin vleften 4.000.000(kater milion) leke. Kapitali i mesiperme eshte nenshkruar dhe shlyer ne masen 100% nga Ortaku Themelues **Hamdi Mesi**.

Neni 4

Kapitali themeltar mund te rritet me shtimin e aktivitetit te Shoqerise. Zvogelimi i Kapitalit Themeltar nen vleften 4.000.000 (kater milion) Leke e detyron Shoqerine te shndrrohet ne nje forme tjeter, ne rast se ajo nuk merr vendim per rritjen e Kapitalit deri ne vleften e mesiperme.

Neni 5

Pjese ose i gjithe i kapitali mund te transferohen me pelqimin e Ortakut Themelues. Transferimet e Kapitalit do te vertetohen me akt Noterial.

Neni 6

Ne rast vdekjeje te Ortakut Themelues, trashegimtaret e ligjshem mund te marrin pjese ne Shoqerine "DRAGO " ShPK (SH.R.S.F). Kur trashegimtaret e ligjshem refuzojne te marrin pjese, atehere Shoqeria i nenshtrohet likuidimit.

Neni 7

Ortaku I vetem themelues ose persona te autorizuar prej tij kane te drejte qe me nxjerrjen e bilanceve vjetore , te perfitojne perqindjet e realizuara nga veprimtaria private . Shoqeria mban pergjegjesi per te gjitha detyrimet shtetore , sigurimet shoqerore etj. Per shkeljet e ndryeshme e te mundeshme te parashikuara ne statut , ortaku themelues mund te marre masa ndeshkimore ndaj kujtdo qe demton pasurine e shoqerise duke filluar nga Drejtuesi teknik dhe punonjesit e sherbimit qe varen prej tij

JURIDIKSIONI

Neni 7


Selia e Shoqerise do te jete ne adresen Nikel – Kruje

Te gjitha mosmarreveshjet me personat juridik e financiar , vendas e te huaj si dhe organet shtetore , zgjidhen me mirekuptim ne zbatim te legjislacionit shqiptar , net e kunderten zgjidhja e tyre mund te behet sipas procedurave ligjore gjyqesore .

Administrator i shoqerise do te jete ortaku i vetem Zoti Hamdi Mesi .

Drejtuesi teknik i zgjedhur nga Administratori - Ortaku i vetem do te jete Zoti Ibrahim Brama duke respektuar kerkesat e ligjit 8770 date 19.04.2001

THEMELUESI
ADMINISTRATORI
HAMDI MESI



STATUTI

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " DRAGO " Shpk

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME



Neni 1

Ne baze te kriterëve te percaktuara ne ligjin nr. 7512 date 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private , nismes se lire , veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit " Kushtetutes se Republikës se Shqiperise , Kodit Tregetare te Republikës se Shqiperise , Ligjit nr. 8770 date 19.04.2001 " Per sherbimin e ruajtjes dhe te sigurise " akte te tjera ligjore , ne tirane me date //09.2006 (dymije e gjashte , shtetasi shqiptare Hamdi Mesi me banim ne Nikel Kruje , me vullnetin e tij te lire e te plote , ne perputhje me legjislacionin shqiptare , vendosi te krijoje nje shoqeri private me Pergjegjesi te kufizuar " DRAGO " shpk(SH.R.S.F.) Nikel - Kruje

Neni 2

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " DRAGO " shpk eshte person juridik I pavarur , ka te drejta dhe detyrime per te cilat pergjigjet Brenda kufijve te percaktuara ne Ligjin Nr. 7512 date 10.08.1991 , Kodin tregetare , ligjin nr. 8770 date 19.04.2001 dhe aketeve te tjera ligjore .

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne baze te ekonomise te tregut te lire.

Neni 3

Ortaku themelues ne kete sipermarrje ka derdhur kapitalin e tij vendas, me qellim qe te perfitojne te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private e Shoqerise, si dhe te perballoje humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne Kapitalin themeltar.

Neni 4

Shoqeria "DRAGO " Shpk (SH.R.S.F) Nikel – Kruje eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar ne rregjistrimin ne Gjykatën e Rrethit Tirane dhe paisjes me lejen e ushtrimit te profesionit nga Zyra e Tatimeve e Rajonit perkates.

EMRI, SELIA, TERRITORI

Neni 5

Emertimi i Shoqerise do te jete : *Shoqeria Private me Pergjegjesi te kufizuar "DRAGO "shpk.*

A handwritten signature in black ink, consisting of a stylized 'S' followed by a flourish.

Neni 6

Selia e Shoqerise do te jete ne adresen Nikel - Kruje
Shoqeria ne perspektive mund te zhvilloje aktivitetin e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise, duke hapur per kete vendqendrim te dyta, filiale dhe perfaqesi, me miratimin e organeve kompetente.

O B J E K T I

Neni 7

Objekti i veprimtarise dhe aktiviteti i kesaj shoqerie private do te jete :

Ruajtja e objekteve shtetore dhe private vendase dhe te huaja ne te gjithe teritorin e vendit , ruajtja e rendit ne keto objekte dhe sigurimin e jetes se personit dhe te vlerave pasurore te tyre gjate levizjes .

AFATI I VEPRIMTARISE

Neni 8

Aktiviteti privat i Shoqerise do te zhvillohet me nje kohezgjatje prej me shume se 10 vjet.

Neni 9

Shoqeria eshte e detyruar te mos ndryshoje destinacionin e saj .

Ndryshimi i destinacionit te veprimtarise ekonomike e financiare brenda dy vjeteve mund te behet me lejen e organeve kompetente .

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 10

Kapitali themeltar i shoqerise tregtare private "DRAGO " Shpk (SH.R.S.F), perbehet nga kontributi fillestare i themeluesit te shoqerise dhe arrin vlefte 4.000.000(kater milion) leke. Kapitali i mesiperme eshte nenshkruar dhe shlyer ne masen 100% nga Ortaku Themelues Hamdi Mesi .

Neni 11

Kapitali themeltar mund te rritet me shtimin e aktivitetit te Shoqerise. Zvogelimi i Kapitalit Themeltar nen vlefte 4.000.000 (kater milion) Leke e detyron Shoqerine te shndrrohet ne nje forme tjeter, ne rast se ajo nuk merr vendim per rritjen e Kapitalit deri ne vlefte e mesiperme.



Neni 12

Pjese ose i gjithe i kapitali mund te transferohen me pelqimin e Ortakut Themelues. Transferimet e Kapitalit do te vertetohen me akt Noterial.

Neni 13

Ne rast vdekjeje te Ortakut Themelues, trashegimtarete e ligjshem mund te marrin pjese ne Shoqerine "DRAGO" ShPK (SH.R.S.F). Kur trashegimtarete e ligjshem refuzojne te marrin pjese, atehere Shoqeria i nenshtrohet likuidimit.

DREJTIMI ADMINISTRATIV

Neni 14

Shoqeria "DRAGO" ShPK(SH.R.S.F) do te kete si Administrator Ortakun Themelues Z HAMDI MESI. Themeluesi ka kompetence te zgjedhe drejtuesin teknik dhe punonjes sherbimi si dhe persona te tjere, ti punesoje, te cilet nuk kane cilesine e ortakut, ne perputhje me ligjin Nr. 8770 date 19.04.2001. Si drejtues teknik te kesaj shoqerie Ortaku i vetem dhe administratori i shoqerise ka zgjedhur Zortin Ibrahim Brama

Neni 15

Administratori ka per detyre organizimin dhe drejtimin e veprimtarise te Shoqerise. Ai mund te kryeje te gjitha veprimet e administrimit ne interes te Shoqerise.

Neni 16

Drejtuessi teknik pergjigjet para ortakut te vetem, ka te gjitha kompetencat e vendim marrese qe kane te bejne me organizimin dhe drejtimin e shoqerise. Ai pergjigjet para ortakut te vetem per te gjitha detyrimet qe ka ne aktivitetin e Shoqerise e ne perputhje me legjislacionin perkates.

Ne marredhenie me te tretet administratori e angazhon Shoqerine nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Neni 17

Administratori ka keto kompetenca:

- Te hartoje raportin e administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore.
- Rregullon marredheniet e punesimit dhe te shperblimit brenda Shoqerise.
- Sipas akteve Ligjore ben shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve Shteterore, personave Juridike ose Fizike vendas ose te huaj.
- Ne rast kur Administratori eshte i emeruar nga themeluesi i Shoqerise kryen te gjitha veprimet e administrimit te shoqerise te deleguara nga themeluesi i shoqerise, me perjashtim vetem te atyre qe jane ne kompetence te themeluesit te shoqerise.



Neni 18

Administratori ka te drejte te informohet per veprimtarine e Shoqerise, si dhe te njihet me dokumentat e saj dhe llogarite perkatese ne rast se keto mbahen nga persona te tjere te caktuar prej tij.

Neni 19

Administratori e humbet detyren e tij ne rast te prishjes se Shoqerise dhe, kur eshte i zgjedhur, kur shkarkohet nga Ortaku i Vetem Themelues.

Neni 20

Ortaku I vetem themelues ka keto kompetenca :


- Ushtron kompetencat e asamblese dhe te Presidentit te Shqiperise
- Miraton programin e shoqerise , harton raportin e administrimit , inventaret ,llogarite vjetore , te cilat hartohen Brenda nje afati 6 mujor duke filluar nga data e mbylljes se viti financiare . per kete mund te marre eksperte , specialiste per te nxjerre bilancet ekonomike , fitim - humbjet ne baze te ligjit " Mbi kontabilitetin ".
- Vendos shperndarjen e shoqerise
- Vendos per ndarjen e fitimeve dhe te humbjeve
- regullon marredheniet e punesimit dhe te shperblimit Brenda shoqerise
- perfaqeson Shoqerine ne marredhenie me te tretet
- Sipas akteve ligjore , shlyen detyrimet ndaj organeve shteterore , personave juridike vendas dhe te huaj
- Cakton drejtuesin teknik dhe punonjkes sherbimi dhe mund te punesoje persona te tjere qe i cmon te nevojshem per aktivitetin e shoqerise etjere

Neni 21

Ne raste se administrimi i shoqerise kryhet nga nje administrator i zgjedhur posacerisht nga ortaku i vetem ky i fundit miraton aktet e administrimit brenda afateve te mesiperme dhe ka te drejte te informohet personalisht per veprimtarine e shoqerise si dhe te njihet me llogarite dhe dokumentat e shoqerise .

Neni 22

Administratori humbet detyren e ngarkuar ne raste te prishjes se shoqerise ose kur shkarkohet nga ortaku i vetem themelues i shoqerise , ne rastin e fundit , shkarkimi i administratorit behet ne baze te nje akti me shkrim te themeluesit te shoqerise .Ne raste se shkarkimi behet pa te drejte ai le shkak per demshperblim.



KREU II

MARREDHENIET FINANCIARE

Neni 23

Shoqeria "DRAGO " Shpk (SH.R.S.F), mund te lidhe Kontrata me sektore Shtetere, drejtperdrejt ne tregun e lire, si dhe me Persona Juridike e Fizike vendas a te huaj.

Neni 24

Ne veprimet Kontraktuale Shoqeria perfaqesohet nga Administratori i saj Z. Hamdi Mesi ose persona te tjere te caktuar prej tij. Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per Shoqerine.

Neni 25

Shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhjes se tij, sigurimet shoqerore, etj. Ajo ka te drejte te çele llogari likuiduese prane Bankave te vendit dhe te kryeje veprimet likuiduese nepermjet tyre.

Neni 26

Per sigurimin e veprimtarise ekonomike Shoqeria ka te drejte te vetfinancohet ne Leke ose ne valute te huaj. Shkembimin e monedhes shqiptare ne monedhe te huaj dhe anasjelltas mund ta beje ne perputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar ose ne tregun e lire privat te valutes.

Neni 27

Per pasqyrimin e aktivitetit privat, *Administratori* ose persona te tjere te caktuar prej tij, jane te detyruar te mbajne dokumentacion te rregullt financiar dhe rregjistrat perkates sipas Ligjit te veçante.

Neni 28

Veprimtaria ekonomike e Shoqerise mbaron ne muajin Dhjetor te çdo viti. *Administratori* ose personat e caktuar prej tij jane te detyruar te paraqesin bilanc vjetor dhe deklaraten e te ardhurave dhe t'i depozitojne ne organin financiar te juridiksionit perkates.

KREU III

MARREDHENIET E PUNESIMIT

Neni 29

Ortaku themelues vendos per shtimin ose pakesimin e numrit te ortakeve dhe personave te tjere te punesuar ne veprimtarine e Shoqerise "DRAGO " Shpk (SH.R.S.F).

Neni 30

Maredheniet e punesimit brenda Shoqerise rregullohen sipas kontrates se punes qe lidhet midis paleve, ne perputhje me Legjislacionin shqiptar.

Neni 31

Marrja ne punes behet me rregjistrimin nga punedhenesi ne Librin e Punes se Shoqerise, si dhe duke njoftuar organet e Punes te juridiksionit ku ushtron aktivitetin Shoqeria.

Neni 32

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga Administratori. Largimi lidhet me mbarimin e Kontrates se Punes, per shkak te shkeljeve disiplinore, ose me vete kerkesen e te interesuarit. Mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se Shoqerise "DRAGO" Shpk (SH.R..S.F), do te zgjidhen me mirekuptim te paleve, te cilat per kete qellim mund te caktojne nga nje perfacues me prokure. Kur mirekuptimi s'eshte i mundur, palet i drejtohen Gjykates se Tiranes.

MBYLLJA E SHOQERISE

Neni 33

Veprimtaria e Shoqerise "DRAGO" Shpk, mbaron me 31.12.2010, ose me pare sipas vendimit te marre nga Ortaku i Vetem Themelues. Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi. Shoqeria "DRAGO" shpk (SH.R.S.F) ka vulen e saj Nese ne cfardo lloj kohe dhe per cfardo lloj arsyeje vendoset prishja e shoqerise, Ortaku i Vetem Themelues percakton modalitetet e likujdimit dhe emerone nje ose disa likujdatore duke ju percaktuar dhe detyrat.

Neni 34

Kur Shoqeria "DRAGO" Shpk(SH.R.S.F) likujdohet Ortaku i Vetem Themelues emerone komisionin e likujdimit, ose nje likuidator i cili paraqet bilancin e likujdimit dhe Shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij bilanci. Mjetet financiare, te fituara si rezultat i veprimtarise se Shoqerise dhe fondet financiare i kalojne Ortaku te Vetem Themelues, pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

Neni 35

Kryetari dhe anetaret e Komisionit te revizionit kontabel, nuk duhet te jene ne vartesi te "DRAGO" SHPK (SH.R.S.F). Komisioni i revizionit kontabel eshte pergjegjes per veprimtarine e vet.

Neni 36

Persa nuk eshte shprehur ne statut, gjithcka i referohet Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", dhe ligjit ne vecanti dhe Legjislacionit Shqiptar ne pergjithesi. Statuti eshte hartuar me vullnet tim dhe eshte firmosur prej meje

Neni 37

Shoqeria "DRAGO" shpk (SH.R.S.F) ka vulen e saj
ORTAKU THEMELUES

HAMDİ MESİ

Hamdi Mesli

36940

K E R K E K E S E

REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

3. h. Dogga
13. 09. 2006
13 SHTATOR 2006

K R U J E S I T / 1. Hamdi Mesi I biri I Shabanit dhe I
kelindjes 21.05.1949 , shtetas shqiptare , me banim ne adresen ne Nikel
" I paisur me pasaporte Z 1707876

E K T I / Kerkoj regjistrimin si person juridik shoqerise

" DRAGO " SHPK me seli ne NIKEL -KRUJE Ortaku i vetem.

TES SE RRETEBIT GJYQSOR TIRANE

Z.Kryetare

Ne baze te ligjit Nr. 7512 date 19.11.1992 dhe ligjit 8778 date 19.04.2001
sherbimin e ruajtjes dhe sigurise publike " une i nenshkruari
Mesi kam vendosur te themelojme ne Shqiperi ne Nikel Kruje nje
i me perqendrimi te kufizuar te emertuar "DRAGO" SHPK per ruajtjen
i me selt ne Nikel-Kruje ne me kapital themeltare konforme ligjit ne
me Administratore :Hamdi Mesi dhe Drejtues teknik Ibrahim Brama ,me
fatje te veprimtarise se shoqerise te pakufizuar ,me objekt sic eshte
tuar qarte ne statutin e shoqerise dhe aktin e themelimit
agjitur

nga ana juaj te vendoset regjistrimi si person juridik I shoqeris
" SHPK Tirane.

agjitur kesaj kerkese jane : Statuti dhe aktin e themelimit te
se, konferma bankare e derdhjes se kapitalit themeltare te shoqerise.

SPEKT

U S E S I

VETEM

MESI

Pyj Aem
Dogga
Dogga